

SHKOLLA FILLORE " PJETER BOGDANI "

NR. 128/93

30.09.1993 vj.

P r i s h t i n ë

INSPEKTORIT KOMUNAL TË PUNËS

PËR

INSPEKTORIN REPUBLIKAN TË PUNËS

P R I S H T I N E

Kundër akt-vendimit të inspektorit komunal të punës nr.01/ të datës 14.09.1993 mbrenda afatit ligjor ushtrojmë.

A N K E S E

a)për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike.

A r s y e t i m

Lidhur me akt-vendimin tuaj nr. 01/1 të datës 14.09.1993 me të cilën është urdhëruar shkollës fillore "Pjetër Bogdani" në Prishtinë që, ndër të tjera, t'i ndërprehet marëdhanja e punës puntorëve të kësej shkolle Hilmi Malokut dhe Hateme Malokut arsimtar të gjhës shqipe dhe arsintare e mësimi klasor, ndërse në detyrat e tij të punës të pranohet Agim Gashi në kohë të pa caktuar, i cili për ndryshe e ka zavendësuar puntorin Hilmi Malokun për kohë të caktuar, ju informojmë më sa vijon:

Këshilli i arsimtarëve të shkollës fillore "Pjetër Bogdani" në Prishtinë e shqyrtoj akt-vendimin tuaj me nr. dhe datë të lëshuar dhe në seancën e mbajtur më datën 7 dhe 23 shtator 1993 dhe gjeti se akt-vendimi i lartpërmendur nuk ka mbështetje ligjore në pjesën që ka të bëjë me pushimin e marëdhanjës së punës puntorit Hilmi Malokut dhe Hateme Malokut, prandaj në këtë pjesë nuk u zbatua akt-vendimi në fjalë.

Arsyet për mos zbatimin e akt-vendimit tuaj lidhur me pushimin e punës puntorëve Hilmi Malokut dhe Hateme Malokut konstatojmë më sa vijon:

1.Puntori Hilmi Maloku dhe Hateme Maloku ishin në marëdhanje pune në këtë shkollë në kohë të pa caktuar dhe ishin të caktuar në detyrat e punës si arsimtar të gjhës shqipe dhe arsintare e mësimi klasor.